

UDHËZUES



MBI PLOTËSIMIN E DOKUMENTIT ZYRTAR DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE

Treguesi i lëndës

Hyrje *faqja*[2]

- Ilustrim i plotësimi të dokumentit zyrtar Deklaratë e Interesave Private “Para Fillimit të Detyrës” *faqja* [7-25]
 - Ilustrim i plotësimi të deklaratës nga zyrtari
 - Ilustrim i plotësimi të deklaratës nga bashkëshorti/ja me pasuri të regjistruar veç
 - Ilustrim i plotësimi të deklaratës nga fëmijët madhorë brenda dhe jashtë gjendjes familjare të subjektit

- Ilustrim i plotësimi të dokumentit zyrtar Deklaratë e Interesave Private “Periodike Vjetore” *faqja* [26-44]
 - Ilustrim i plotësimi të deklaratës nga zyrtari
 - Ilustrim i plotësimi të deklaratës nga bashkëjetuesja e subjektit
 - Ilustrim i plotësimi të deklaratës nga fëmijët madhorë jashtë gjendjes familjare të subjektit me pasuri veçmas
 - Ilustrim i plotësimi të deklaratës nga fëmijët madhorë në një përbërje me zyrtarin, pa pasuri veçmas

- Shpjegime të veçorive të plotësimi të dokumentit zyrtar Deklaratë e Interesave Private “Pas Largimit nga Funkzioni” *faqja* [45-46]

- Ilustrim i plotësimi të dokumentit zyrtar Deklaratë e Interesave Private “Me kërkesë” *faqja* [47-52]

HYRJE

❖ **Ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave janë:**

- Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, me ligjin nr. 9475, datë 09.2.2006, me ligjin nr. 9529 datë 11.5.2006, ligjin nr. 85/2012 datë 18. 9.2012, ligjin nr. 45/2014 datë 24.4.2014 dhe ligjin nr. 42/2017 datë 6.4.2017
- Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar me ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, me ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, me ligjin nr. 9690 datë 5.3.2007, me ligjin nr. 86/2012 datë 18.9.2012 dhe me ligjin nr. 44/2014 datë 24.4.2014.
- Ligji nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

❖ **Subjektet që mbartin detyrim për deklarim periodik në ILDKPKI:**

Bazuar në pikën 1 dhe 2 neni 3 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë”, i ndryshuar, mbartin detyrimin për deklarim periodik në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave:

- a) Presidenti i Republikës, deputetët e Kuvendit, Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministrat e zëvendësministrat;
- b) gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe inspektorët e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;
- c) zyrtarët e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues, sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, me përjashtim të organeve të vetëqeverisjes vendore;
- ç) prefektët, kryetarët e këshillave të qarqeve dhe kryetarët e bashkive;
- d) drejtorët e drejtorive dhe komandantët e Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shërbimin Informativ Shtetëror;
- dh) prokurorët, gjyqtarët, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror dhe drejtuesit e zyrave përmbartimore brenda juridiksionit të çdo rrethi gjyqësor të shkallës së parë;
- e) drejtuesit e institucioneve të pavarura publike dhe anëtarët e enteve rregullatore;
- ë) Drejtori dhe Zëvendësdrejtori i Policisë së Shtetit, drejtorët e përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtorët e drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtorët e drejtorive vendore të Policisë së Shtetit,

drejtuesi dhe oficerët e policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, nëpunësit civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe personeli administrativ i Prokurorisë së Posaçme;

f) Drejtori i Përgjithshëm, zëvendësdrejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive në qendër dhe qarqe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;

g) drejtuesit e të gjitha niveleve të strukturave të kthimit e kompensimit të pronave, të privatizimit dhe regjistrimit të pasurisë,

gj) zyrtarët, që zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi, Presidenti i Republikës, Kryeministri, ministrat ose personat e barazuar me ta;

h) Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, zëvendësguvernatori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj.

i) drejtuesit e institucioneve publike në varësi të institucioneve qendrore në nivel qarku;

j) administratorët e shoqërive anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind dhe me më shumë se 50 punëtorë.

2. Mbartin detyrimin për deklarim edhe personat që, sipas nenit 9 të këtij ligji, mbartin detyrimin e deklarimit me kërkesë.

2.1. Mbartin detyrimin për deklarim edhe subjektet e parashikuara në nenet 26 dhe 27, të ligjit nr. 84/2016, “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.*”

Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të personave të lidhur me të (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjekti, **brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.**

Kur pasuria e personave të lidhur është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo person i lidhur, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.

Anëtari i familjes dhe personi i lidhur me subjektin deklarues mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara.

Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private” është miratuar me “Urdhër nr. 223, datë 9.5.2017 nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, “*Për miratimin e formularëve të deklarimit të interesave private*”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 101 datë 9.5.2017.

● **Llojet e interesave private që deklarohen periodikisht janë:**

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 (treqind mijë) lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;
- dh) detyrimet financiare ndaj personave juridik dhe fizik, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;
- e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale;
- ë) liçencat dhe patentat që sjellin të ardhura;
- f) dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtime preferenciale kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi;
- g) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim;
- gj) interesa privatë të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës;
- h) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300 000 (treqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.

Kuitesë

1. Deklarata e interesave private plotësohet vetëm në mënyrë elektronike (me kompjuter), por gjithmonë nënshkrimi duhet të plotësohet nga vetë zyrtari subjekt i deklarimit, si dhe nga vetë personi i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe/ose fëmijët madhorë) kur disponojnë pasuri veçmas e të regjistruar në emrin e tyre.
2. Zyrtari për vete dhe personat e lidhur në faqen nr.2 të deklarimit duhet të plotësoj detyrimisht **numrin personal** në kolonën përkatëse.
Bashkëlidhur Deklarimit të interesave private "**Para Fillimit të Detyrës**" zyrtari duhet të dorëzojë: kopje të letërnjoftimit (Kartës së Identitetit) për vete, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore. Për fëmijët e tjerë zyrtari duhet të dorëzojë fotokopje të pasaportës ose të çertifikatës personale.
Mos plotësimi i këtij detyrimi passjell mospranimin e deklaratës së interesave nga ILDKPKI dhe për pasojë ndaj zyrtarit do të aplikohen sanksione për refuzim të deklarimit të interesave private.
3. Subjekti/zyrtar nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave private të personave të lidhur.
4. Kur bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore **nuk kanë pasuri të regjistruar veçmas**, plotësojnë dhe nënshkruajnë vetëm faqen 8 të deklaratës "Autorizimi" dhe i bashkëlidhet deklaratës së zyrtarit.
5. Kur bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore kanë pasuri të regjistruar veçmas, plotësojnë dhe nënshkruajnë secili, faqen 8 deri 11 të deklaratës së interesave private .



SANKSIONET

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
- Për mosdeklarim para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, deklaruesi (zyrtari, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore) dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Ilustrim i plotësimit të dokumentit zyrtar Deklaratë e interesave private “Para fillimit të detyrës”

KUJTESË: Para se të plotësoni dokumentin zyrtar, deklaratë e interesave private, lexoni me vëmendje shpjegimet dhe kërkesat e pasqyruara në formularin përkatës të deklaramit.

Deklarimi i interesave private nga zyrtari (subjekti deklarues)

- Dokumenti zyrtar “**Deklaratë e interesave private para fillimit të detyrës**” duhet të plotësohet nga zyrtari që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklaram, por edhe në rastet kur zyrtari ka patur ndërprerje për më tepër se një vit nga funksioni i mëparshëm (nga deklarami i fundit Pas Largimit).
- Në plotësimin e formularit të deklaramit duhet të tregohet kujdes me plotësimin e saktë të emrit, atësisë, mbiemrit, datëlindjes dhe numrit personal të zyrtarit, familjarëve dhe/ose personave të lidhur, në faqet ku kërkohet plotësimi i të dhënave familjare (fq.2).
- Të saktësohet adresa e regjistrimit në Gjendjen Civile, si dhe adresa e vendqëndrimit nëse është e ndryshme nga e para (fq.2 e deklaramit).
- Deklarami përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare.
 1. Në deklaramin “**Para fillimit të detyrës**” duhet të deklarohen të gjitha pasuritë e akumuluarat ndër vite, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë dhe të drejtat real mbi to sipas Kodit Civil nga zyrtari dhe/ose në bashkëpronësi me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë, **deri në datën e fillimit të detyrës**.
Në çdo rast duhet të deklarohen në mënyrë analitike burimet e krijimit për çdo aset. Duhet të mbahet në vëmendje fakti që deklarohet vlera e blerjes apo e shpenzimeve të kryera dhe jo vlera e tregut për periudhën e deklaramit (faqe 3 e deklaramit).
 2. Në deklaramin “**Para fillimit të detyrës**” duhet të pasqyrohen të ardhurat neto nga angazhime në veprimtari private dhe/ose publike nga **1 janari deri në datën e fillimit të detyrës dhe jo të ardhurat vjetore**. (fq.4 e deklaramit).
Në lidhje me të ardhurat nga biznesi, duhet të deklarohet fitimi neto i tërhequr. Po kështu edhe për të ardhurat nga qeraja, duhet të deklarohet shuma neto, e përfutur pas pagimit të detyrimeve tatimore.
 3. Në faqen e të ardhurave, të përcaktohet qartë institucioni ku është i punësuar personi i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore) i subjektit apo aktiviteti që ushtron.
 4. Në rastin e kredive bankare, duhet të deklarohet vetëm gjendja e kredisë në datën e fillimit të detyrës dhe jo gjendja e kredisë + interesa të llogaritura. (fq.5 e deklaramit).
 5. Kur deklarohen likuiditetet, duhet të shënohet banka në të cilën janë kryer veprimet.
 6. Do të deklarohet çdo send me vlerë të veçantë mbi 300.000 lekë si piktura, orë dore apo orë tavoline, suvenire, pajse të ndryshme dhe çdo send tjetër që nuk regjistrohet në regjistrat publikë.
 7. Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes, bashkëjetuesit/es është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarami paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, bashkëjetuesit/es me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaramit së personit që ka detyrimin për deklaram.
 8. Formulari i deklaramit plotësohet në mënyrë elektronike, por në çdo rast nënshkruhet me shkrim.
 9. Subjekti/zyrtari nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaramin e interesave private të personave të lidhur.
 10. Deklarami duhet të plotësohet dhe dorëzohet, **jo më vonë se 30 ditë, nga data e fillimit të detyrës**.

Deklarimi i interesave private nga personi i lidhur me zyrtarin (subjektin deklarues)

- ❖ Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private e personit të lidhur” duhet të plotësohet nga pjesëtarë të familjes (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklaram në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, për pasuritë që disponojnë veçmas.
- ❖ Personi i lidhur me zyrtarin, (**bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore**), i cili mbart detyrimin për deklaram të interesave private në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 8-11.

- ❖ Në çdo rast, personi i lidhur është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës, **AUTORIZIMI** ku deklarohen nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.
- ❖ **Kujdes:** Të gjithë zyrtarët dhe personat e lidhur me ta (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore), të cilët bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklarin për herë të parë, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion Lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI.
- ❖ Bashkëlidhur Deklarimit të interesave private zyrtari duhet të dorëzojë: kopje të letërnjoftimit (kartës së identitetit) për vete, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore. Për fëmijët e tjerë zyrtari duhet të dorëzojë fotokopje të pasaportës ose të çertifikatës personale. Mosplotësimi i këtij detyrimi passjell mospranimin e deklaratës së interesave nga ILDKPKI dhe për pasojë ndaj zyrtarit do të aplikohen sanksione për refuzim të deklarimit të interesave private.

Kujdes: Të gjitha faqet e formularit të deklaratës duhet të nënshkruhen, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.

- Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me Seksionin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse në numrat e telefonit **042 259 461** Free.08009999, info@hidaa.gov.al.
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.hidaa.gov.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi
në ILDKPKI
dhe Viti

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE
PARA FILLIMIT TË DETYRËS

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklarim të interesave private të tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet e pasqyruara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, Ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, me Ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012, Ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014 dhe Ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE

Emri

ALBERT

Atësia

BUJAR

Mbiemri

PROKA

Funksioni

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Institucioni dhe adresa

MINISTRIA X

Data e emërimit në detyrë

15.05.2017

Data e dorëzimit të deklaratës

12.06.2017

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

A u t o r i z o j:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Dekloroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i subjektit deklarues

ALBERT PROKA (firma)

**TË DHËNA PERSONALE TË
SUBJEKTIT DHE
PERSONAVE TË LIDHUR**

PËRBËRJA FAMILJARE E ZYRTARIT SIPAS ÇERTIFIKATËS SË GJENDJES CIVILE

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruësin	Gjendja Civile
ALBERT	BUJAR	PROKA	11.03.1956	G22586963F	DEKLARUESI	Martuar
VJOLLCA	AGIM	PROKA	07.02.1959	T47851269L	Bashkëshortja	Martuar
DRITAN	ALBERT	PROKA	03.09.1977	K26791584S	I biri	Beqar
ANA	ALBERT	PROKA	21.04.1981	H23265236F	E bija	Beqar

Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në Gjendjen Civile:
Njësia Administrative Nr. , Rruga, Pallati nr., Bashki/Komunë)

Rr. Pjetër Budi Pallati 171, Shk 5, Ap 14 Tiranë

Nëse dispononi vendqëndrim tjetër,
dresa e plotë ku banoni:

Nuk disponoj

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruësin	Gjendja Civile
BUJAR	SAMI	PROKA	14.07.1928	D14586963F	Babai i deklaruësit	Martuar
KOZETA	GJERGJ	PROKA	19.05.1934	D45851269E	Nëna e deklaruësit	Martuar
AGIM	TRITAN	LONI	21.02.1933	J01791584Q	Babai i bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	Martuar
TATJANA	LLAZI	LONI	26.04.1937	M23265536F	Nëna e bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	Martuar
ALMIR	ALBERT	PROKA	14.03.1975	Z19735864N	I biri/e bija e ndarë nga prindërit	Martuar
					Bashkëjetuesi/ Bashkëjetuesja	

Bashkëlidhur zyrtari (subjekti deklaruës) duhet të dorëzojë:

- Fotokopje të letërnjoftimit (kartës së identitetit) për vete, bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore.
- Fotokopje të pasaportës ose të çertifikatës personale për fëmijët e tjerë.
Të dhënat në këtë faqe janë konfidenciale

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklaruës

ALBERT PROKA (firma)

**DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Objekti i deklaramit: Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në ditën e fillimit të detyrës, sipas gërmës a, b, c, ç, d * të nenit 4 dhe nenit 4/1 të Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të zotëruara nga zyrtari, apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë.

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
1	Apartament banimi, sip 120 m2, Rr: Pjetër Budi, Tiranë Blerë me datë 01.06.2015 Burimi i krijimit: Kredi nga BKT 5.000.000 lekë; Terheqje dividendi nga Sha "Artir" 2.000.000 lekë, në vitin 2015.	7.000.000 lekë (shtatë milion)	100
2	Aksione në Sha "ARTIR" Tiranë blerë më 15.04.2010 në shumën 7 milion lekë.(35% të shumës gjithsej të aksioneve 20.000.000 lekë). Burimi i krijimit: Shitje trualli të trashëguar nga prindërit sip 1500 m2, Rr: P. Budi, Tiranë, më 15.01.2010 shuma 7 milion lekë	7.000.000 lekë (shtatë milion)	35
3	Depozitë Tirana Bank krijuar më 15.07.2012 dhe gjendje më 15.5.2017. Burimi i krijimit: Të ardhura nga bashkëshortja avokate për periudhën Janar 1998- Mars 2012 në shumën 27.000 Euro dhe dhuratë nga prindërit 3.000 Euro.	30.000 Euro (tridhjetë mijë)	100
4	Dhënë hua, më datë 2.5.2016 një shtetasi Burimi i krijimit: Nga dividendi i tërhequr në Artitr Sha më 30.4.2016	1.000.000 lekë (një milion)	100

* **Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar:**

- pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 lekë**;
- vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash** jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

* **Neni 4/1.** Subjekti deklarues që plotëson deklaramin për herë të parë, nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion lekë është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI.

*Nëse ky format është i pamjaftueshëm,
vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.*

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

ALBERT PROKA (firma)

**DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Objekti i deklarimit: Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në ditën e fillimit të detyrës, sipas gërmës a, b, c, ç, d * të nenit 4 dhe nenit 4/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të zotëruara nga zyrtari, apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë.

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumën e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
5	Truall me sipërfaqe 1.200 m2 me adresë Lagjia nr.2 Rruga M.Barleti Shkodër. Burimi i krijimit: Trashëguar nga prindërit	0	100
6	Autoveturë tip Pugeot, prodhim i vitit 2007, me targa AA282KU blerë më 20.5.2014. Burimi i krijimit: 1. Pa paguar shitësit 6.000 Euro 2. Kursime familjare 4.000 Euro	10.000 Euro (dhjetëmijë)	100
7	Llogari bankare në Procredit bank, gjëndje më 15.5.2017 Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat	300.000 lekë (treqindmijë)	100
8	Depozitë në BKT shuma 25.000 Euro, çelur më 11.6.2014. Gjendje më 15.5.2017 shuma 25.000 Euro Burimi i krijimit: Nga shitja e truallit me sipërfaqe 700 m2 Rruga Qemal Stafa Tiranë	25.000 Euro (njëzetepesëmijë)	100

* **Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar:**

- pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 lekë**;
- vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash** jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

* **Neni 4/1.** Subjekti deklarues që plotëson deklarinimin për herë të parë, nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion lekë është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI.

*Nëse ky format është i pamjaftueshëm,
vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.*

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

ALBERT PROKA (firma)

**ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI
PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE**

Objekti i deklaramit: Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; të subjektit, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore, për periudhën nga data 1 Janar deri në datën e fillimit të punës së vitit të deklaramit.

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit nga 1 Janari deri datën e fillimit të detyrës.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)
1.Administrator “Andi” Shpk Janar- 15.5.2017	850.000 lekë (tetëqind e pesëdhjetë mijë)
2. Bashkëshortja Vjollca Proko, antare e Këshillit Mbikqyrës në Bankën e Shqipërisë Janar- 15.5.2017	600.000 lekë (gjashtëqindmijë)
3.Bashkëshortja Vjollca Proka, Pedagoge në Fakultetin e Ekonomisë të ardhura nga paga Janar deri 15.5.2017	400.000 lekë (katërqindmijë)
4.Të ardhura nga shitja e librit në Fakultetin e Ekonomisë bashkëshortja Janar-15.5.2017	200.000 lekë (dyqindmijë)
5. Tërheqje dividendi nga “Artir” Sh.a më 30.4.2017	1.000.000 lekë (njëmilion)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit

ALBERT PROKA (firma)

**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e fillimit në detyrë të subjektit deklarues.

Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve subjekti deklarues ka detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr. 7, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare shumën e kredisë (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe këstin mujor.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të detyrës (me shifra dhe me fjalë)
Kredi për blerje apartament banimi me sipërfaqe 120 m ² në BKT, më 01.06.2015, në shumën 7.000.000 lekë me afat 20 vjet. Gjendje më 15.5.2017 shuma 5.000.000 lekë Shlyerja fillon më 01.6.2015 dhe përfundon më 01.6.2035 me 8% interes në vit dhe me këst mujor 40.000 lekë.	5.000.000 lekë (pesë milion)
Detyrim ndaj firmës "Vjosa" Sh.a për blerje autoveturë tip Peugeot më 20.5.2014. sipas kontratës nr.xxx	6.000 Euro (gjashtë mijë)
Kartë krediti në Raifeisen Bank	150.000 lekë (njëqindpesëdhjetëmijë)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

ALBERT PROKA (firma)

TË DHËNA KONFIDENCIALE

Të dhëna konfidenciale në lidhje me; pasuri private të paluajtshme dhe/ose të luajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, detyrime financiare, burimet e origjinës së pasurive, identitetin e personit juridik ose fizik huadhënës a huamarrës, emërtesën e institucionit publik ose privat me të cilët keni marrëdhënie interesi.	Nr.i regjistrit publik, Nr. kontratës noteriale, data/muaji/viti
1-Apartament banimi Rr. Pjetër Budi Tiranë sip 120 m2	Kontratë blerje Nr. Rep 7281 Kol 379 datë 1.6.2015
2-Depozitë bankare Tirana Bank krijuar më 15.7.2012, Rruga e Dibrës, Tiranë 3-Aksione në Sha “ARTIR” Tiranë blerë më 15.04.2010 në shumën 7 milion lekë	Nr xxx datë 15.7.2012 Kontratë nr. Rep 78297 ; Kol 549 datë 15.4.2010
4-Dokumant për huadhënie kunatës Genta Bici , në dt. 2.5.2016. 5- Truall me sipërfaqe 1.200 m2 me adresë Lagjia nr.2 Rruga M.Barleti Shkodër.	Rep 1593 Kol 279 datë 2.5.2016 Akt trashëgime Nrxx

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me zyrtarin që mbart detyrimin për deklaram:

Emër, Atësi, Mbiemër i personit fizik dhe /ose emërtimi i personit juridik	Lidhja me deklaruësin	Lloji i interesave private, vendndodhja e tyre.
ARTIR Sh.a me objekt veprimtarie “Tregtim me shumicë karburantesh”	Aksioner	7.000 aksione me vlerë 7 milion lekë duke zotëruar 35% të vlerës. Adresa: Rr e Parisit, Tiranë

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

**Emri, Mbiemri,
Nënshkrimi i subjektit deklaruës**

ALBERT PROKA (firma)

Telefon celular

0695745213

Telefon privat/zyre, faks, e-mail

042 245 589



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.hidaa.gov.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE
E PERSONIT TË LIDHUR

Nr. Indeksi në ILDKPKI	
---------------------------	--

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklaram në bazë të nenit 22 të Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE

Në bazë të nenit 9/1, të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar,

Autorizoj:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasi/sja <u>Vjollca Agim Proka,</u> Emër, Atësi, Mbiemër	bashkëshorti/ja <input checked="" type="checkbox"/> fëmijë madhorë së bashku me prindërit <input type="checkbox"/> fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit <input type="checkbox"/> bashkëjetuesi/ja <input type="checkbox"/>	X <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
i/e Subjektit <u>Albert Bujar Proka</u> Emër, Atësi, Mbiemër		

Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:

Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim	<input checked="" type="checkbox"/>
Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim	<input type="checkbox"/>

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur
<u>Vjollca Proka(firma)</u>

**DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Objekti i deklaramit: Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në datën e fillimit të detyrës, sipas gërmës a, b, c, ç, d * të nenit 4 dhe nenit 4/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil, të ndodhura brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të zotëruara nga personi i lidhur me subjektin deklarues.

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie* të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
1	Vilë dy kate me sip. 180m2 Golem Kavajë, ndërtuar në vitin 1995 dhe Përfitur me akt trashëgimie nga prindërit më 01.03.2010. Vlera e mobilimit dhe pajisjeve: 2.000.000 lekë, Prill 2010 Burimi i krijimit: Kursime nga të ardhurat familjare.	2.000.000 lekë (dy milion)	100
2	Truall me sip 300 m2 , Pogradec blerë më 01.09.2016. Burimi i krijimit: Kredi nga Raiffeisen Bank 1.500.000 lekë dhe 500.000 lekë të ardhura familjare.	2.000.000 lekë (dy milion)	100

***Objekti i deklaramit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil.
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 leke;**
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash**, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

* **Neni 4/1** Subjekti deklarues që plotëson deklaramin për herë të parë, nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumë 1.5 (një presje pesë) milion Lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion Lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI

*Nëse ky format është i pamjaftueshëm,
vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.*

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

Vjollca Proka(firma)

**ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI
PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE**

